

Shkollat Publike Worcester Worcester Technical High School

RREGULLORJA EMERGJENTE E PRANIMIT

Dhjetor 2020

I. PARATHENIE (INTRODUCTION)

Procesi i pranimit është i nevojshëm në shkollat profesionale dhe teknike kur vendet janë një faktor i limituar. Labororet profesionale teknike janë krijuar dhe pajisur për të shërbyer me siguri një numri specifik maksimal nxënësish. Si pasojë, një kompleks i këtyre laboratoreve kanë mungesë vendi dhe fleksibiliteti për të akomoduar nevojat e mundëshme/ose interesin e të gjithë aplikantëve. Prandaj, është i nevojshëm një proces zgjedhjeje për të përcaktuar se cilët aplikantë mund të përfitojnë më shumë nga këto mundësi mësimore. Të gjithë aplikantët nga klasa e nëntë në të dymbëdhjetë në Worcester Technical High School janë vlerësuar duke përdorur kriteret që ndodhen në këtë Rregullore Pranimi. Komiteti i Shkollave Publike të Worcester e aprovoi këtë rregullore në 1 Qershor, 2017.

Më 12 Mars 2020, Charlie Baker, Guvernatori i Massachusetts, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe lëshoi directive për mos-udhëtim dhe mbylljen fizike të shkollës për shkak të Coronavirus (COVID-19). Shkollat u udhëzuan të kalonin në një platformë mësimore në internet. Lëvizja për të mësuar në internet u formulua nga zyrtarë të Distriktit, Bashkisë dhe Komitetit të Shkollës me kontribut nga komuniteti për t'i shërbyer sa më mirë nxënësve dhe familjeve dhe për të minimizuar barrierat për shkak të COVID-19 për akses të barabartë në të gjitha programet arsimore.

Ndikimi i COVID-19 në procesin arsimor është rraskaptës. Kjo rregullore përshkruan në mënyrë specifike ndikimin dhe udhëzimet e reja pasuese në procesin e pranimeve për Kapitullin 74, programimin profesional brenda Distriktit. Një rregullore emergjence u hartua me kujdes për procesin e pranimeve 2021-2022 për të siguruar transparencë për nxënësit, familjet dhe distriktet dërguese. Komiteti i Shkollave Publike Worcester miratoi këtë rregullore më 7 janar 2021 dhe rregullorja do të jetë në fuqi për studentët që aplikojnë për t'u regjistruar për vitin shkollor 2021-2022.

II. MUNDESITE E BARABARTA MESIMORE (EQUAL EDUCATIONAL OPPORTUNITY)

Shkolla e Mesme Teknike e Worcester (Worcester Technical High School) pranon nxënësit dhe u vendos atyre në dispozicion avantazhet, privilegjet, dhe kurset e studimit pavarësisht racës, ngjyrës, seksit, besimit fetar, origjinës kombëtare, orientimit seksual, identitetit gjinor ose paaftësisë.

Nëse ka ndonjë nxënës me aftësi të kufizuar në Anglisht, një përfaqësues i kualifikuar nga Shkolla e Mesme Teknike e Worcester do të ndihmojë aplikantin në plotësimin e formave të nevojshme, dhe do të ndihmojë me përkthimin gjithë procesit të aplikimit dhe pranimit sipas kërkesës së aplikantit.

Nxënësit me paaftësi (disable) mund të vetë-identifikohen me qëllim për të kërkuar akomodime të arsyeshme gjatë të gjithë procesit të aplikimit dhe pranimit.

Informacioni në lidhje me aftësinë e kufizuar në Anglisht dhe paaftësinë, e paraqitur vullnetarisht nga aplikanti, për qëllimin e marrjes së ndihmës dhe akomodimeve gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe pranimit, nuk do të ndikojnë në pranimin e tyre në shkollë.

III. PRANUSHMERIA (ELIGIBILITY)

Cdo nxënës i klasës së tetë që është rezitent i Distriktit të Shkollave Publike të Worcester dhe që pret të promovohet në klasën e nëntë është i përshtatshëm për të aplikuar për pranimin në vjeshtë, duke qënë subjekt i disponueshmërisë së vendeve bosh tek Shkolla e Mesme Teknike e Worcester. Nxënësit residentë do të vlerësohen duke përdorur kriteret që ndodhen në këtë Rregullore Pranimi.

Nxënësit që transferohen nga shkolla të tjera profesionale teknike janë të përshtatshëm për të aplikuar për pranimin gjatë vitit shkollor për klasat 9-12 në Shkolla e Mesme Teknike e Worcester, me kusht që ata të kenë pritshmërinë që do të promovohen në klasën që ata kërkojnë të hyjnë, nga shkolla e tyre aktuale. Nxënësit që transferohen do të vlerësohen duke përdorur kriteret që ndodhen në këtë Rregullore Pranimi.

Shkollat Publike Worcester janë distrik shkollor me zgjedhje, ju lutem referohuni tek Worcester Public Schools, School Choice Policy.

IV. STRUKTURA ORGANIZATIVE (ORGANIZATIONAL STRUCTURE)

Shkolla e Mesme Teknike e Worcester (Worcester Technical High School) është një shkollë publike profesionale teknike që ndodhet në Worcester, Massachusetts. Shkolla e Mesme Teknike e Worcester është pjesëtare e Distriktit të Shkollave Publike të Worcester dhe është e akredituar nga Shoqata e Shkollave dhe Kolegjeve të New England (New England Association of Schools and Colleges). Shkolla e Mesme Teknike e Worcester është e përkushtuar që të ofrojë programe akademike dhe profesionale teknike me kualitet.

Është përgjegjësia e Superintendent (Mbikqyrëses) të Shkollave Publike të Worcester që të mbikqyrë administrimin e rregullave dhe rregulloreve që kërkohen për të pranuar dhe regjistruar aplikantët në përputhje me këtë Rregullore Pranimi.

Shkolla e Mesme Teknike e Worcester ka një Komitet Pranimi të emëruar nga Drejtori. Komiteti konsiston nga një anëtar nga Administrata, Udhëheqja (Guidance), Nevojat Speciale, Departamentet Akademike dhe Profesionale Teknike. Përgjegjësitë e Komitetit të Pranimi përfshijnë:

- A. përcaktimi i standarteve të pranimit
- B. krijimi dhe implementimi i procedurave të pranimit
- C. shqyrtimi i aplikimeve
- D. renditja e nxënësve
- E. pranimi i nxënësve sipas procedurave dhe kriterëve të kësaj rregulloreje pranimi
- F. krijimi dhe mbajtje e listës së pritjes të kandidatëve të pranueshëm.

Shkollat Publike të Worcester marrin pjesë në Programin e Zgjedhjes së Shkollës (School Choice Program).

V. PROCESI I REKRUTIMIT (COVID- 19 UDHEZUES I RI)

1. Shkolla e Mesme Teknike e Worcester shpërndan informacionin rreth shkollës nëpërmjet një shumëllojshmërie metodash gjatë impaktit të Covid-19:
 - a. Të gjithë nxënësit e klasave të teta të Shkollave Publike dhe Shkollave Charter të Worcester do të kenë akses në një *tur virtual* të Shkollës së Mesme Teknike Worcester në platformat mediatike të lidhura me Shkollat Publike Worcester. Linket aktive të *turit virtual shkollor* ofrohen në shkollat e mesme (middle) nga Shkolla e Mesme Teknike Worcester për programet e ndërgjegjësimit të karrierën. Një letër që përshkruan procesin e pranimeve do t'i dërgohet me postën e SHBA çdo nxënësit të klasës së tetë në Shkollat Publike Worcester, në gjuhën amtare të familjes së tyre.
 - b. Një Open House Virtuale është programuar për në Janar 2021. Nxënësit e mundshëm dhe prindi(ërit)/kujdestari(ët) kanë mundësi që ti vizitojnë të gjitha programet profesionale teknike, të flasin me mësuesit, si dhe të shikojnë prezantimin që jepet për çdo gjë që ofrohet. Shkollat Publike të Worcester do të ofrojnë një përkthim me shkrim në tetë gjuhët më të folura të distriktit për të gjitha materialet e Open House.
 - c. Informacioni më i përditësuar do të jetë i disponueshëm përmes platformave në internet të lidhura me Shkollën e Mesme Teknike Worcester dhe Shkollat Publike Worcester.

VI. PROCESI I APLIKIMIT (APPLICATION PROCESS)

PROCESI I APLIKIMIT-PER PRANIMIN NE VJESHTE PER NE KLASAT E NENTE, DHJETE, NJEMBEDHJETE DHE DYMBEDHJETE

1. Nxënësit e interesuar për të aplikuar për në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester për pranim në vjeshtë për klasat e nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë duhet që të plotësojnë një aplikim online.
2. Është përgjegjësi e Këshilltarit Udhëzues të shkollës dërguese që të:
 - a. Ndihmojë në plotësimin e aplikimit në internet nga ekipi mësimor i nxënësit deri më 1 Prill. Aplikimet e plota përfshijnë:
 - (i) Formën e plotësuar të aplikimit (përfshirë elementët e kërkuara).
 - (ii) Për aplikimet për në klasën e 9 (pranimi në vjeshtë), kërkohet mesatarja e notës përfundimtare të klasës së 7-të dhe notat e klasës 8 në termat 1 dhe 2 në artet në gjuhën angleze (ose ESL, cilado që është më e lartë), studimet sociale, matematikë dhe shkencë nga karta e raportit të shkollës dërguese / transkripti. Për aplikimet në klasat 10, 11 dhe 12 (pranimi i vjeshtës), kërkohet mesatarja e vitit shkollor të mëparshëm dhe notat e termave 1 dhe 2 të vitit shkollor aktual në artet në gjuhën angleze, studimet sociale, matematikë dhe shkencë nga karta e raportit të shkollës dërguese / transkripti.

· aplikim për pranim gjatë dimrit dhe pranverës për ti filluar klasat në vjeshtën e ardhshme.

Për aplikimet për në klasën e 9 (pranimi në vjeshtë), totalja e mungesave të klasës së 7 dhe simestrave 1 & 2 të klasës së 8 nga raporti i shkollës/transkripti i shkollës dërguese **nuk** kërkohet.

Për aplikimet për në klasat e 10, 11 & 12 (pranimi në vjeshtë) totalja e mungesave pa-arsye të vitit të kaluar shkollor dhe simestreve 1 & 2 të vitit aktual shkollor nga raporti i shkollës/ transkripti i shkollës dërguese **nuk** kërkohet.

Për aplikimet në klasën 9 (pranimi në vjeshtë), kërkohet mesatarja e vlerësimeve të *sjelljes dhe përpjekjes* të klasës 7 tremujorët 1, 2, dhe 3 dhe termve 1 dhe 2 të klasës 8 nga karta raportuese e shkollës dërguese ose *vlerësimi i shkollës* dërguese. Për aplikimet në pranimet në klasat 10, 11 dhe 12 (pranimi i vjeshtës), kërkohet mesatarja e vitit të kaluar shkollor dhe termat 1 dhe 2 të vlerësimeve të vitit shkollor të *sjelljes* nga karta e raportit të shkollës dërguese ose *vlerësimi i shkollës* dërguese.

Rekomandimi i shkollës dërguese kërkohet për aplikimet në klasat 9, 10, 11 dhe 12 (pranimi i vjeshtës). Rekomandimi do të jetë nga një ekip arsimtarësh që përfshin udhëzues profesionistë (guidance professionals), mësues dhe / ose administratorë që e njohin dhe kanë punuar drejtpërdrejt me nxënësin.

3. Nëse marrim aplikime të paplota, do të ndiqen procedurat e mëposhtëme:
 - a. Zyra e Pranimit (Admission Office) të Shkollës së Mesme Teknike Worcester do të njoftojë Guidance Counselor të shkollës dërguese, i cili është përgjegjës për dërgimin e aplikimit, se ky aplikim është i paplotë dhe se duhet të plotësohet.
 - b. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga Guidance Counselor i shkollës dërguese, do të njoftohet prindi(ërit)/kujdestari(ët) i aplikantit nga Zyra e Pranimit të Shkollës së Mesme teknike të Worcester.
 - c. Nëse pas njoftimit të Guidance Counselor të shkollës dërguese dhe prindit(ërve)/kujdestarit(ëreve), aplikimi qëndron i paplotësuar për dhjetë ditë shkolle, aplikimi do të quhet i pavlefshëm.

PROCESI I APLIKIMIT - PER PRANIM NE KLASAT E NENTE, DHJETE, NJEMBEDHJETE DHE DYMBEDHJETE PER VITIN SHKOLLOR AKTUAL².

1. Nxënësit e interesuar për të aplikuar për pranim në Shkollën e Mesme Teknike Worcester për vitin aktual shkollor duhet që të:
 - a. plotësojnë një aplikim online.
2. Eshtë përgjegjësi e Guidance Counselor të shkollës dërguese që të:
 - a. plotësojnë pjesën e tyre të formularit të aplikimit. Shkollat dërguese do të marrin njoftimin elektronik për pikat që kërkojnë veprim në aplikim.
 - b. Për aplikime për klasat 9, 10, 11 & 12 (pranim gjatë të njëjtit vit shkollor) kërkohen nga kartat e raportit/ transkripti i shkollës dërguese, notat e vitit aktual shkollor deri në datën e aplikimit, në artet e gjuhës Angleze, studimet sociale, matematikë dhe shkencë.

². aplikim për pranim gjatë vitit shkollor për të filluar klasat gjatë të njëjtit vit shkollor, në krahasim me aplikimin për pranim në një vit shkollor për të filluar shkollë në vjeshtën e vitit tjetër shkollor.

Për aplikimet në klasat 9,10,11 & 12 (pranimi gjatë vitit shkollor), mungesat e pajustificuara për vitin shkollor aktual deri në datën e aplikimit nga karta e raportit shkollor / transkriptimi NUK kërkohen.

Për aplikimet në klasat 9, 10, 11 & 12 (pranimi gjatë vitit shkollor) kërkohet vlerësimi i sjelljes i vitit shkollor aktual deri në datën e aplikimit nga karta e shkollës dërguese ose nga vlerësimi i shkollës dërguese.

Për aplikimet në klasat 9, 10, 11 dhe 12 (pranimi gjatë vitit shkollor) kërkohet rekomandimi i shkollës dërguese.

3. Nëse marrim aplikime të paplota, do të ndiqen procedurat e mëposhtëme:
 - a. Zyra e Pranimit (Admission Office) e Shkollës së Mesme Teknike Worcester do të njoftojë Guidance Counselor të shkollës dërguese, i cili është përgjegjës për dërgimin e aplikimit, se ky aplikim është i paplotë dhe se duhet të plotësohet.
 - b. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga Guidance Counselor i shkollës dërguese, do të njoftohet prindi(ërit)/kujdestari(ët) i aplikantit nga Zyra e Pranimit të Shkollës së Mesme teknike të Worcester.
 - c. Nëse pas njoftimit të Guidance Counselor të shkollës dërguese dhe prindit(ërve)/kujdestarit(ëreve), aplikimi qëndron i paplotësuar për dhjetë ditë shkolle, aplikimi do të quhet i pavlefshëm.

APLIKIMET ME VONESE (LATE APPLICATIONS)

Aplikimet që do të vijnë pas 1 Prillit do të vlerësohen në bazë të rendit të marrë duke përdorur të njëjtat kritere si aplikimet e tjera, por vetëm pasi aplikuesve të vendosur në listën e pritjes u është ofruar pranimi.

NXENESIT E TRANSFERUAR (TRANSFER STUDENTS)

Aplikimet nga nxënës që janë të regjistruar në një program të një shkolle tjetër të mesme profesionale teknike të aprovuar nga shteti (Kapitulli 74) (nxënësit që transferohen), do të konsiderohen për tu pranuar (përfshirë pranimin gjatë të njëjtit vit shkollor) nëse ata/ato zhvendosen nga shkolla e tyre aktuale dhe dëshirojnë që të ndjekin të njëjtin program studimi në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester. Të gjithë aplikantët që do të transferohen duhet që të bëjnë një intervistë në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester. Aplikimet e tyre do të vlerësohen sipas kushteve të Rregullores së Pranimit.

NXENESIT QE SHKOLLOHEN NE SHTEPI (HOME-SCHOOL STUDENTS)

Aplikimet për nxënësit rezidentë të cilët janë të regjistruar në një program të aprovuar për tu shkolluar në shtëpi, të cilët aplikojnë për në Shkollën e Mesme Teknike Worcester, do të ndjekin procedurat që përmbahen në këtë rregullore pranimi dhe do të vlerësohen duke përdorur kriteret që përmbahen në këtë Rregullore Pranimi.

NXENESIT QE TERHIQEN (WITHDRAWN STUDENTS)

Nxënësit që tërhiqen nga Shkolla e Mesme Teknike e Worcester, dhe që ndjekin ose jo një shkollë tjetër të mesme (high school), mund të riaplikojnë për në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester duke ndjekur procedurat që ndodhen në këtë rregullore pranimi dhe do të vlerësohen duke përdorur kriteret që ndodhen në këtë Rregullore Pranimi.

VII. KRITERET E PERZGJEDHJES (SELECTION CRITERIA)

Aplikimet e plotësuar shqyrtohen nga Komiteti i Pranimit (Admission Committee) duke përdorur kriteret e ponderuara të pranimit (weighted average). Cdo aplikanti do ti jepet pikë të cilat dalin nga shuma e nën pikëve të kriterëve të mëposhtëme:

- A. Arrijtjet Shkollore (Scholastic Achievement): Maksimumi 25 pikë
Performanca Akademike (25%) (e plotësuar nga WTHS), Nota përfundimtare e Klasës 7, Klasa 8 Nota e Tremujorëve 1 dhe 2..... (25 pikë, shkalla e pikëve bonus)
- B. Notat e sjelljes dhe përpjekjes për katër lëndët kryesore (mesatarja e 5 tremujorëve, 3 tremujorë nga klasa e 7-të dhe tremujorët 1 dhe 2 nga klasa e 8-të)..... (25 pikë)
- C. Rekord i pjesëmarrjes/ mungesave të shkollës (për shkak të ndikimit të pandemisë, të gjithë nxënësve do t'u jepet vlera e plotë e pikëve).....(25 pikë)
- D. Rekomandim nga Ekipi i Mësimdhënies, ndihmuar nga këshilltari udhëzues / drejtori (udhëzuesit profesionistë, arsimtarët e licensuar ose administratorët që njohin dhe kanë punuar drejtpërdrejt me nxënësin)..... (25 pikë)

Matematikë, Shkencë, Histori, Anglisht (ose ESL)

A = 3.5, B = 3, C = 2.5, D = 2, F = 0. Pikët totale = 25, shkalla e pikëve të bonusit.

Për aplikimet në klasën 9 (pranimi në vjeshtë), janë përdorur nota përfundimtare e klasës 7 dhe klasa 8 notat në termat 1 & 2 në anglisht (pranimi i rezultatit më të lartë skollistik të ESL ose ELA), studimet sociale, matematikë dhe shkencë nga karta e raportit të shkollës dërguese. Për aplikimet në klasat 10, 11 dhe 12 (pranimi i vjeshtës) përdoret mesatarja e vitit të kaluar shkollor dhe notat e termave 1 & 2 të vitit shkollor aktual në anglisht, studimet sociale, matematikë dhe shkencë nga karta e raportit të shkollës dërguese. Për aplikimet në klasat 9, 10, 11 dhe 12 (pranimi gjatë vitit shkollor) përdoren notat e vitit shkollor aktual deri në datën e aplikimit në anglisht, studime sociale, matematikë dhe shkencë nga karta e raportit të shkollës lokale.

B. Mungesat: 25 pikë do tu jepet aplikantëve

Numri i Mungesave Pa-arsye	Pikët
TE GJITHE	25

C. Sjellja dhe Përpjekja: Maksimumi 25 pikë

Klasifikimi i Sjelljes/Përpjekjes	Pikët
A	25
B	20
C	15
D	10
E	0

Për aplikimet në klasën 9 (pranimi në vjeshtë), **mesatarja e notës së tremujorëve 1, 2 dhe 3 të klasës 7 dhe tremujorëve të 1 & 2 të klasës së 8të në sjelljes / përpjekje**. Përdoret vlerësimi nga kartat e raportit të shkollës dërguese ose vlerësimi i ekipeve të shkollës dërguese. Për aplikimet në klasat 10, 11 dhe 12 (pranimi në vjeshtë) përdoret mesatarja e vitit të kaluar shkollor dhe vlerësimi i termave 1 dhe 2 të vitit shkollor aktual nga karta e shkollës dërguese ose nga vlerësimi i ekipeve të shkollës dërguese. Për aplikimet në klasat 9, 10, 11 dhe 12 (pranimi gjatë vitit shkollor), përdoren vlerësimet e vitit shkollor aktual deri në datën e aplikimit nga karta e raportit shkollor / transkripti ose nga vlerësimi i shkollës dërguese.

D. Rekomandimet e Ekipit Mësimdhënës: Maksimumi 25 pikë

Rekomandimi do të jetë nga një Ekipi i përbërë nga udhëzuesi profesionistë, arsimtarë të licensuar, dhe/ose administratorët që njohin dhe kanë punuar drejtpërdrejt me nxënësin

Propozim i RI për Përmbledhjen e Vlerësimit të Profilit

Kategoria	Pikët për çdo kategori (5=shkëlqyer)
A. Arritjet në lidhje me aftësinë	0-5
B. Aktivizimi në klasë	0-5
C. Motivimi	0-5
D. Përgjegjësia personale	0-5
E. Interesi në mësimin teknik profesional	0-5

Pasi janë dhënë pikët në çdo fushë, pikët mbledhen për çdo aplikant. Maksimumi i pikëve që mund të merren nga çdo aplikant është njëqind (100).

VIII. PROCESI I PERZGJEDHJES (SELECTION PROCESS)

Të gjitha aplikimet do të kenë 25 pika të deklaruara për pjesëmarrjen/ mungesat.

Komiteti i Pranimit të Shkollës së Mesme Teknike të Worcester do të shqyrtojë, diskutojë dhe japë rekomandime se si të veprohet me aplikantët.

Komiteti i Pranimit merr në konsideratë arritjet shkollore, sjelljen në shkollë, dhe rezultatet e rekomandimit të Guidance Counselor. Aplikimet shqyrtohen, procesohen dhe u jepen pikë sipas nivelit të klasës.

Pasi është përcaktuar totalja e pikëve për çdo aplikant, të gjithë aplikantët vendosen në renditje sipas "totalit të pikëve" të tyre. Aplikantët pranohen në bazë të pikëve totale që ata kanë marrë. Aplikanti me pikët më të larta pranohet i/e pari, aplikanti i dytë nga totali i pikëve të marra pranohet i dyti, dhe vazhdohet kështu deri sa të gjitha vendet të plotësohen. Aplikantët pranohen, refuzohen ose vendosen në listën e pritjes. Nëse hapen vende, këto vende plotësohen duke pranuar aplikantë nga lista e pritjes. Këta aplikantë, njësoj si ata që janë pranuar më përpara, pranohen në bazë të vendit të tyre në listën e pritjes, që përcaktohet nga numri total i pikëve të marra sipas kriterëve të përzgjedhjes.

Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve janë marrë nga Shkolla e Mesme Teknike Worcester deri më 1 Prill njoftohen për statusin e tyre me një letër drejtuar prindërve / kujdestarëve të tyre deri në mes të majit.

Aplikimet e marra pas 1 Prillit do të merren në konsideratë në rradhën e marrë duke përdorur të njëjtat kriterë, por vetëm pasi aplikantëve të vendosur në listën e pritjes t'u ofrohet pranimi.

IX. REGJISTRIMI (ENROLLMENT)

Për tu regjistruar për në vjeshtë në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester, aplikantët duhet që të kenë kaluar në klasën që ata kërkojnë të hyjnë në shkollën që i dërgon ata/ato. Veç kësaj, ata/ato duhet që të kenë kurse në artet e gjuhës Angleze dhe ose ekuivalente dhe matematikë për vitin shkollor menjëherë para regjistrimit në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester.

X. VENDOSJA NE PROGRAMIN PROFESIONAL TEKNIK (VOCATIONAL TECHNICAL PROGRAM PLACEMENT)

Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë që regjistrohen në Shkollën e Mesme Teknike të Worcester marrin pjesë në një program shpjegues profesional, të krijuar për ti ndihmuar ata që të mësojnë rreth talentit dhe interesave të tyre në lidhje me një varietet të ndryshëm programesh teknike dhe profesionale. Në fillim nxënësit eksplorojnë çdo akademi profesionale dhe teknike për një ditë gjatë javës së tyre teknike. Pastaj nxënësit kanë opsionin që të ndryshojnë një zgjedhje të repartit bazuar në mini eksperiencën eksploruese. 4 zgjedhjet e para të nxënësit, të marra nga aplikimi origjinal, së bashku me 4 zgjedhje të marra nga numri total i reparteve (shops) të disponueshme, planifikohen për të gjithë periudhën eksploruese e cila është e përbërë nga Quarter 1 dhe Quarter 2. Nxënësit vlerësohen dhe renditen (0-100 pikë) duke përdorur një rubrikë të standartizuar sipas çdo reparti (shop) & mësuesit specifik gjatë dy javëve në çdo repart.

Në fund të kësaj periudhe me zgjedhje tetë javore eksploruese, çdo nxënës zgjedh programin e tij/saj të preferuar nga një deri në gjashtë nga programet që ata/ato eksploran. Nxënësit pranohen në repartin e zgjedhur prej tyre duke u bazuar në numrin total të pikëve që ata/ato marrin nga shuma e pikëve totale të të gjithë reparteve. Për shembull, një nxënës me mesatare totale pikësh prej 100 do të pranohet përpara një nxënësi me një mesatare totale pikësh 80. Nëse një repart plotësohet, bazuar në numrin më të lartë total të pikëve, nëse një nxënës nuk pranohet në programin e parë të zgjedhur prej tij/saj, Drejtori i Karierrës në Edukimin Teknik Profesional kalon në zgjedhjen e dytë deri në të gjashtë të nxënësit duke u bazuar në vendet e hapura që ka në ato reparte. Prapë, nxënësit pranohen bazuar në mesataren e pikëve totale. Nëse totalja e pikëve të kombinuara në të gjitha repartet e një nxënësi është aq e ulët sa nuk e vendos atë në repartin e zgjedhur nga dy deri në atë të gjashtë sepse vendet u plotësuan nga nxënës me numër total pikësh më të lartë,

Drejtori i Karierrës në Edukimin Teknik Profesional do të takohet me nxënësin dhe do ti prezantojë atij/asaj një listë me reparte që kanë vende bosh të cilat nxënësi mund ti eksplorojë dhe gjithashtu do ti kërkohet që të zgjedhë një prej tyre. Prapë, nxënësit që zgjedhin këto reparte do të pranohen bazuar në numrin total të pikëve të tyre. Procesi vazhdon derisa të gjithë nxënësit të jenë vendosur në një repart.

Nxënësit që dëshirojnë që të transferohen nga një repart tek tjetri gjatë vitit shkollor, mund të aplikojnë për një transfertë duke përdorur një formë të standartizuar nga këshilltari udhëzues (guidance counselor) i tyre. Kërkesat për transfertë do të jenë subjekt i paisjes së vendeve bosh në repartin e kërkuar, si dhe planit të karrierës. Cdo aplikat që kërkon të transferohet do të intervistohet dhe konsultohet individualisht për të përcaktuar përshtatshërinë e transfertës për nxënësin e veçantë.

XI. RISHIKIM dhe APELIMI (REVIEW and APPEALS)

Prindi(ërit)/kujdestari(ët) i nxënësit, pas marrjes së një letre nga Shkolla e Mesme Teknike e Worcester që tregon se aplikanti nuk është pranuar ose vendosur në listën e pritjes, mund të kërkojnë një rishikim të vendimit duke dërguar një letër tek Drejtori që të kërkojë një rishikim brenda 30 ditësh nga marrja e kësaj letrë. Drejtori do ti përgjigjet me shkrim kësaj letrë, ku do të shpjegojë gjetjet e rishikimit brenda 30 ditësh. Nëse pas rishikimit prindi/kujdestari dëshiron që të apelojë gjetjet e këtij rishikimi, ata mund ta bëjnë këtë duke dërguar një letër, që kërkon që ata të programohen për tu takuar me Worcester Public Schools Secondary Manager për Instruction and School Leadership për të apeluar gjetjet e Drejtorit. Secondary Manager për Instruction and School Leadership do ti përgjigjet me shkrim prindit/kujdestarit me një datë të planifikuar për apelimin brenda 30 ditësh nga marrja e letrës. Secondary Manager për Instruction and School Leadership do ti përgjigjet me shkrim kësaj letrë, ku të japë vendimin e apelit, brenda 30 ditësh nga data e takimit me Secondary Manager për Instruction and School Leadership nga data e mbajtjes së apelit.